




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 21/20
Datë: 20.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 20 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Fushën e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe për Deklarimin, Prejardhjen e Pasurisë.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

KONCEPT DOKUMENTI PËR FUSHËN E AGJENCISË KUNDËR KORRUPSIONIT DHE PËR DEKLARIMIN, PREJARDHJEN E PASURISË

Kapitulli 1: Hyrje

Në kuadër të Planit Vjetor të Punës të Qeverisë, për vitin 2017, pjesa e Ministrisë së Drejtësisë (Tabela B, Objektivi nr. 1 pika 1.2) është paraparë hartimi i Koncept Dokumentit për fushën e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe për deklarimin, prejardhjen e pasurisë. Poashtu kjo parashihet edhe me Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Korrupsioni është një ndër pengesat kryesore në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm politik, ekonomik dhe shoqëror të një shteti. Në renditjen e indeksit global në lidhje me perceptimin e korrupsionit në vendet e Evropës dhe të Ballkanit Perëndimorë, Kosova renditet në një pozitë jo të favorshme me 36 pikë dhe tani renditet në vendin e 95 nga gjithsej 176 shtete. Prandaj, është në interes të Kosovës që të përmirësoj imazhin e saj në luftën kundër korrupsionit dhe parandalimin e korrupsionit.

Parandalimi dhe luftimi i korrupsionit është një obligim që rrjedh nga anëtarësimi i Kosovës në organizatat ndërkombëtare për luftën kundër korrupsionit, e paraparë me Konventat e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, dhe standardeve tjera kundër korrupsionit.

Përveç bazës ligjore, në shkurt 2013 Parlamenti i Kosovës ka miratuar edhe Strategjinë Kundër Korrupsionit si dhe Planin e Veprimit 2013-2017. Aktualisht Agjencia është duke punuar në hartimin e Strategjisë dhe planit të veprimit të ri kombëtar kundër korrupsionit për periudhën 2018 - 2022. Edhe pse korniza aktuale ligjore konsiderohet e mirë për të sjellë rezultate të prekshme në këtë fushë, megjithatë ekzistojnë çështje të cilat kërkojnë rregullim edhe më të mirë në mënyrë që të parandalohet dhe të luftohet korrupsioni.

Strategjia për Asistencë në Sektorin e Sundimit të Ligjit në Kosovë 2016-2019 objektivi 10.2. (Objektivi strategjik) përcakton përmirësimin e parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, përfshirë trafikimit me qenie njerëzore dhe narkotikë, krimit ekonomik dhe shpërlarjes së parave, kontrabandës me armë, krimit kibernetikë dhe terrorizmit. Parandalimi dhe

luftimi i krimit të organizuar, korrupsionit dhe krimeve tjera të rënda është i paraparë gjithashtu në faqen 85 të kësaj strategjie.

Kapitulli 2: Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor

AKK-ja që nga funksionalizimi i saj të gjitha rastet të cilat ka hetuar dhe kur ka gjetur prova përtej dyshimit të arsyeshëm dhe të bazuar, ka vepruar sipas kompetencave të saj dhe deri më tani ka përcjellur tek autoritetet kompetente gjithsej 718 raste. AKK ka adresuar numrin më të madh të kallëzimeve penale në raport me vitet paraprake. Kjo është si rrjedhojë që Kodi Penal i Kosovës (i hyrë në fuqi në fillim të vitit 2013) ka paraparë si vepër penale "mos deklarimin e pasurisë" dhe "deklarimin e rrem të pasurisë".

Korniza ligjore në bazë të së cilës Agjencia ka realizuar mandatin e saj është: Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, Ligji nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë, Ligji nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë, (i cili ka hyrë në fuqi më 2014); Ligji nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik. Legjislacioni dytësor ekzistues nuk është plotësuar dhe ndryshuar.

Aktualisht, pjesa më e madhe e punës së AKK-së bazohet dhe funksionon përmes monitorimit dhe sistemit të raportimit që ende nuk është shumë i zhvilluar. Pa mbledhjen dhe trajtimin sistematik të informacionit, do të ishte e pamundshme që AKK të identifikonte, kuptonte dhe vepronte ndaj rrezeve të korrupsionit dhe të dinte nëse rregullat dhe standardet e vendosura janë të përshtatshme, të mjaftueshme dhe nëse përputhshmëria e tyre është efektive. Për këtë arsye, ndryshimi i ligjit thekson domosdoshmërinë që mbledhja e informacionit dhe prodhimi i analizave mbi trendet dhe zonat e rrezikut të jenë në qendër të misionit të AKK-së.

AKK ka vendosur një rrjet të personave kontaktues në administratat e ndryshme për të mbledhur deklaratimet e pasurisë të zyrtarëve të këtyre institucioneve, organeve, zyrave dhe agjencive. Edhe pse ky rrjet integriteti mund të jetë i dobishëm për Agjencinë dhe punën e saj parandaluese (me kusht që këta

individë të kenë kushtet e nevojshme financiare dhe ligjore për të vepruar si zyrtarë të etikës në shërbimet e veta), procedura e përgjithshme për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e përmbajtjes së këtyre deklarimeve është ende në fillimet e veta dhe jo sa kërkohet stabile.

Përkundër progresit të arritur deri më tani, Kosova, sikurse edhe vendet e tjera të rajonit, vazhdon të përballë me vështirësi në sektorin e Sundimit të Ligjit, përkatësisht me mangësi të theksuara në sistemin gjyqësor, çështje të brendshme dhe qasje në drejtësi.

Raportet e ndryshme ndërkombëtare (Dokumentet Teknike të Projekti kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK II) dhe Raportet e Progresit për Kosovën nga Komisioni Evropian) dhe dokumentet strategjike nacionale vënë në pah nevojën për përkushtim shtetëror proaktiv në përmirësimin e efikasitetit të policisë, prokurorisë dhe gjyqësorit në përgjithësi, e veçanërisht në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Duke patur parasysh se zhvillimi socio-politik dhe ekonomik, marrëdhëniet me BE-në si dhe imazhi ndërkombëtar i Kosovës ndikohen thelbësisht nga përparimi në fushën e Sundimit të Ligjit, Qeveria e Republikës së Kosovës, me ndihmën e BE-së dhe partnerëve tjerë ndërkombëtarë ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në reformimin dhe përforcimin e sektorit të Sundimit të Ligjit në tërësinë e tij.

Edhe pse, në përgjithësi, Kosova ka elemente të mjaftueshme të vendosura në kornizën ligjore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, sikurse që ka edhe institucione përkatëse, në aspektin praktik lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar të të gjitha llojeve vazhdon të mbetet sfidë për autoritetet e Kosovës. Kjo çështje duhet të shikohet nga dy aspekte, sa i përket luftimit të brendshëm institucional kërkohet forcimi i mekanizmave të brendshëm të institucioneve përkatëse. Ndërsa në anën tjetër me marrjen e përgjegjësisë të ushtruar nga EULEX-i, vërehet një nevojë e shtuar, ndër të tjera, për profilizimin e mëtutjeshëm të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Rezultatet e zbehta në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit kanë edhe tri arsye kryesore. E para, sepse kësaj strategjie i mungojnë mekanizmat obligues që do të detyronin institucionet për të marrë përgjegjësitë e tyre, e dyta, sepse organizimi institucional mbetet i ndërlikuar për ta adresuar këtë fushë komplekse, dhe e treta, për shkak se ka patur mungesë të pronësisë nga të gjithë akterët përgjegjës për implementimin e kësaj strategjie.

Bazuar në të dhënat e raporteve vjetore vërehet se nevojiten përpjekje të përbashkëta të sistemit të drejtësisë dhe mekanizmave të tjerë që kanë për mision luftën kundër korrupsionit në mënyrë që të ndërtohet një sistem i fuqishëm

institucional që prodhon rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe përfundimisht krijon dhe rritë besimin tek qytetarët.

Përkundrajt kësaj vetëdije politike e shoqërore, me objektivin përfundimtar të modernizimit të qeverisjes në vend, Kosova angazhohet për luftë pa kompromis dhe zero tolerancë kundër korrupsionit duke i dhënë kësaj politike publike përparësinë që meriton.

Megjithëse janë vënë re disa përparime në fushën e luftës kundër korrupsionit, korrupsioni vazhdon të mbetet dukuri shqetësuese për të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës. Përkundër zotimeve për një përkushtim më të madh drejtë krijimit të një ambienti shoqëror të lirë nga ndikimi i korrupsionit, megjithatë rezultatet ende nuk mund të konsiderohen të kënaqshme. Autoritetet kosovare kanë përcaktuar prioritete të qarta për zbatimin e legjislacionit që ka për qëllim luftimin dhe parandalimin e korrupsionit, promovimin e transparencës dhe forcimin e integritetit institucional.

Procedurat për mbledhjen, përpunimin dhe shqyrtimin e deklarimeve të pasurisë janë analizuar dhe janë vërejtur mangësi në zbatim. AKK ka vendosur një rrjet të personave kontaktues në administratat e ndryshme për të mbledhur deklaratimet e pasurisë të zyrtarëve të këtyre institucioneve, organeve, zyrave dhe agjencive. Edhe pse ky rrjet integriteti mund të jetë i dobishëm për Agjencinë dhe punën e saj parandaluese, procedura e përgjithshme për mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e përmbajtjes së këtyre deklarimeve është ende në fillesat e veta. Në këtë aspekt vërehet mungesa e akteve të brendshme në lidhje me punën e zyrtarëve kontaktues dhe shpërndarja e duhur e udhëzimeve për mbushjen e formularëve të deklaratimit të pasurisë nga zyrtarët kontaktues dhe shpërndarja e këtyre formularëve tek zyrtarët e lartë. Po ashtu, aktualisht dënimet për mos-deklarim janë penale dhe paraqesin sfidë në zbatimin praktik.

Sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2013, dështimi për deklarimin e pasurisë ose dhënia e deklaratave të rreme në AKK dhe konflikti i interesave kualifikohen si vepra penale.

AKK mund të kontrolloj ndryshimet dhe modelet në pasurinë e raportuar të zyrtarëve të lartë publikë; por nuk mund të hetojë origjinën e mundshme penale të pasurisë së pajustificuar (kjo është kompetencë e Prokurorisë së Shtetit) ose çështjet e pronësisë së dobishme sa u përket pasurive të caktuara (kjo bie nën mandatin e Njësisë për Inteligjencë Financiare). Megjithatë, ndërsa kontrollon vlefshmërinë e përmbajtjes së deklarimeve të pasurisë, Agjencia mund të krahasoj pasurinë dhe pasuritë e raportuara, duke marrë parasysh provat nga ankesat, lajmet, informacionet e trashëgimisë të vënë në dispozicion të AKK nga hetime të tjera në vazhdim.

E njëjta ndodh edhe me monitorimin e dhuratave. Pjesa më e madhe e mosefikasitetit të saj rezulton nga zbrazëtitat juridike në ligj. AKK nuk duhet të monitorojë listat e dhuratave të marra nga institucione të ndryshme publike, organe, zyra dhe agjenci. Në vend të kësaj, AKK duhet t'i ndihmojë menaxherët e tyre të lartë për t'i ngritur sistemet e pajtueshmërisë publike dhe procedurat e qarta për raportimin dhe trajtimin e dhuratave të zyrtarëve publikë. Duke vepruar kështu, AKK mund të ofrojë një model të menaxhimit të dhuratave (që duhet të përshtatet me specifikën e secilit organ), një doracak se si të hartohet dhe të zbatohet një regjistër për trajtimin e dhuratave, dhe të ofrojë trajnim se pse është e rëndësishme të vendosen këto procedura të brendshme të pajtueshmërisë dhe si duhet të bëhen gjërat.

Mos sanksionimi proporcional i deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik ka qenë sfidë gjatë kësaj periudhe. Prandaj, rekomandohet që të ndryshohet forma dhe mënyra e sanksionimit. Në këtë aspekt duhet të ketë shkallëzime të dënimeve apo të gjenden metoda tjera të ndëshkimeve të zyrtarëve të lartë publik, dhe zyrtarëve të tjerë.. Mungesa e dispozitave të qarta të cilat rregullojnë trajtimin e prejardhjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë publik.

Mos sanksionimi proporcional i deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik ka qenë sfidë gjatë kësaj periudhe. Prandaj, rekomandohet që të ndryshohet forma dhe mënyra e sanksionimit. Në këtë aspekt duhet të ketë shkallëzime të dënimeve apo të gjenden metoda tjera të ndëshkimeve të zyrtarëve të lartë publik, dhe zyrtarëve të tjerë, dhe ri-formulim i përkufizimeve të listës së zyrtarëve të lartë publik. Mungesa e dispozitave të qarta të cilat rregullojnë trajtimin e prejardhjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë publik.

Në këtë kontekst, hartimi i ligjit të ri apo ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 03/1-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe hartimi i ligjit të ri apo ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, dhe Ligjit Nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë është parë si detyrë urgjente, sepse ka si objektive fundamentale reduktimin progresiv dhe të qëndrueshëm të korrupsionit, forcimin e integritetit institucional dhe promovimin e vlerave të mirëqeverisjes.

- Ligji Nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit është miratuar në Kuvend me 29.12.2009, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr. DL-006-2010, Datë 19.01.2010.
- Ligji Nr. 04-L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar - Ligji është miratuar në Kuvend me 31.08.2011, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr.DL-028-2011, Datë 31.08.2011
- Ligji Nr. 04/L-228 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04-L-050 për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të personat zyrtar - Ligji është miratuar në Kuvend me 20.03.2014, kurse është shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës nr.DL-013-2014, Datë 07.04.2014.

Gjatë zbatimit të Ligjeve në fjalë është vërejtur që ekzistojnë disa zbrazëtira juridike dhe ligji nuk është i hartuar në harmoni të plotë me legjislacionin vendor përkatës dhe standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Politika aktuale

Agjencia kundër Korrupsionit (AKK) është institucion i pavarur i themeluar në korrik të vitit 2006, ndërsa ka filluar të funksionojë më 12 shkurt të viti 2007. Agjencia është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë.

Legjislacioni aktual kundër korrupsionit, mbi bazën e të cilit AKK edhe i zhvillon aktivitetet e saj parasheh masat kundër korrupsionit brenda fushës së veprimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, veçanërisht në fushën e hetimeve paraprake të korrupsionit, analizimin dhe eliminimin e shkaqeve të korrupsionit, papajtueshmërinë mes mbajtjes së posteve publike dhe kryerjes së aktiviteteve fitimprurëse për personat zyrtar, kufizimet në lidhje me pranimin e dhuratave të lidhura me kryerjen e detyrës zyrtare, mbikëqyrjen e pasurive të tyre si dhe të personave në lidhje të afërt me ta dhe kufizimet në lidhje me subjektet kontraktuese që marrin pjesë në tenderët publik.

Përmes ndryshimit dhe plotësimit të këtij ligji kërkohet të fuqizohet roli i Agjencisë në hetimet penale dhe administrative. Përveç kësaj, do të ngritet niveli i bashkëpunimit dhe rregullohet mënyra e komunikimit me institucionet vendore siç janë: Prokuroria, Policia, ATK-ja, ARBK, MF, Dogana e Kosovës,

Zyra e Auditorit, Bankat, Agjencia Kadastrale, NjIF, ARC, etj. Agjencia përmes ndryshimit të ligjit kërkon të angazhohet më tepër në fushën e edukimit, bashkëpunimin dhe raportet me media dhe shoqërinë civile dhe angazhimin në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtarë. Si rezultat i kësaj, Agjencia kërkon që të merr kompetenca shtesë në fushat që lidhen me hetimin dhe parandalimin e korrupsionit, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë publik dhe parandalimin e korrupsionit në aktivitete e prokurimit publik.

Në aspektin institucional, Kosova ka themeluar Agjencinë Kundër Korrupsionit (AKK) në vitin 2006. AKK është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë. Në kuadër të përpjekjeve për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, në shkurt 2012, Presidentja e Kosovës ka themeluar Këshillin Kombëtar Kundër Korrupsionit. Qëllimi i themelimit të këtij Këshilli është përmirësimi i koordinimit dhe rritja e vetëdijes në mesin e të gjitha organeve dhe institucioneve të përfshira në luftën kundër korrupsionit.

Për të shtuar përpjekjet për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, më 26 Shkurt 2010, me vendim të Qeverisë, në kuadër të Prokurorisë Speciale të Kosovës, është krijuar një Task Forcë Kundër-Korrupsion e përbërë nga prokurorë (nga Kosova dhe EULEX-i) dhe hetues të policisë. Qëllimi i themelimit të kësaj Task Force është që të hetohet krimi ekonomik dhe financiar. Ndërkohë, në kuadër të këtij mekanizmi, Policia e Kosovës ka themeluar gjithashtu një Drejtori kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit.

Në kuadër të Policisë së Kosovës, Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (DHKEK), e cila ka në kompetencë trajtimin e krimeve ekonomike, financiare dhe të korrupsionit.

Prokuroria e Kosovës udhëheq procedurën e hetimeve penale për rastet të cilat AKK i procedon në Prokurori për procedim të mëtejshëm.

Gjykata shqyrton dhe vendos në lidhje me aktakuzat që ngriten nga Prokuroria për rastet e korrupsionit.

Ndërsa institucionet tjera i ndihmojnë AKK në ofrimin e informacionit në lidhje me zhvillimin e procedurës së hetimeve paraprake dhe realizimit të kontrollit të plotë të formularit të deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publik.

Ndryshimi dhe plotësimi i ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë është i domosdoshëm në mënyrë që ky

ligj të harmonizohet më tutje me legjislacionin vendor përkatës dhe praktikave më të mira të Bashkimit Europian dhe ndërkombëtare. Për më tepër, ky ndryshim dhe plotësim është në harmoni të plotë me përmbushjen e obligimeve që kanë institucionet kosovare në raport me Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit të nënshkruar mes Kosovës dhe BE-së për.

KORNIZA LIGJORE:

LIGJET E MIRATUARA:

Korniza ligjore bazë sipas të cilës Agjencia e ushtron mandatin e saj ligjor janë aktet në vijim por pa u kufizuar në to:

Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Ky ligj përcakton statusin dhe përgjegjësitë e AKK në fushën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit, veçanërisht në fushën e raportimit, zbulimit dhe hetimit të korrupsionit, zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit.

Ligji nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë dhe Ligji nr. 04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-050

Ky ligj përcakton detyrimet e zyrtarëve të lartë publik për të deklaruar pasurinë, të hyrat dhe prejardhjen, detyrën e AKK për ta kontrolluar deklarimin dhe kontrollin e pasurisë si dhe detyrimet e të gjithë pesonave zyrtarë për të deklaruar dhuratat dhe prejardhjen e tyre.

Ligji nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi i konfliktit të interesit ndërmjet interesit publik dhe interesit privat të zyrtarëve të lartë në ushtrimin e funksionit publik.

UDHËZIMET / RREGULLORET E MIRATUARA NGA AKK JANË:

Rregullore nr. 01/2014 e punës e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e punës, rregullat për organizimin dhe funksionimin e punës në Agjencinë kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme: Agjencia)

Rregullore nr 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit

Kjo rregullore përcakton parimet dhe rregullat organizimit, funksionimit, dhe menaxhimit të arkivit të AKK

Rregullore nr.02/2014 për organizimin, funksionalizimin dhe menaxhimin e arkivit të Agjencisë Kundër Korrupsionit

Me këtë Rregullore përcaktohen procedurat dhe parimet për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë kundër Korrupsionit, struktura organizative si dhe ndarja e punëve në kuadër të strukturës organizative ndërmjet vendeve të punës.

Kodi nr.03/2013 i etikës për nëpunësit e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Ky kod ka për qëllim të vendos rregullat e sjelljes për nëpunësit e Agjencisë, në ushtrimin e detyrave në Agjenci dhe jashtë saj, promovimin dhe mbrojtjen e statusit të tyre si dhe rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve në raport me institucionet dhe publikun në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Shpenzimet Aktuale:

Ndryshimi dhe Plotësimi i këtij Ligji nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë **nuk ka kosto** financiare shtesë dhe si rezultat i kësaj mund të përfundojë se nuk ka implikime financiare.

Kategoria e shpenzimeve	Shpenzimet faktike në vitin paraprak	Buxheti këtë vit	KASH për vitin e
-------------------------	--------------------------------------	------------------	------------------

			ardhshëm
Buxheti i Agjencisë: (shëno secilin lloj të shpenzimit)	503,074.00	503,074.00	503,074.00
Buxhetet tjera: (shëno secilin lloj të shpenzimit)	-	-	-
Financimi nga donatorët	-	-	-
Shpenzimet e drejtpërdrejta nga Ministria e Financave	-	-	-

Më poshtë janë paraqitur trendët e financimit dhe të vlerësimit në 3 vitet e fundit. Po ashtu, është paraparë edhe për vitin 2018.

Agjencia Kundër Korrupsionit	2014 aktuale	2015 buxheti	2016 Vlerësimi	2017 Vlerësimi	2018 Vlerësimi
Totali	453,079.07	503,074.00	503,074.00	503,074.00	503,074.00
Nr. i punëtoreve	40	40	40	40	40
Paga dhe mëditje	340,202.41	340,477.00	340,477.00	340,477.00	340,477.00
Mallra dhe shërbime	109,288.42	154,097.00	154,097.00	154,097.00	154,097.00
Shpenzime komunale	3,588.24	8,500.00	8,500.00	8,500.00	8,500.00
Burimet e Financimit:	453,079.07	503,074.00	503,074.00	503,074.00	503,074.00
Grantet qeveritare	453,079.07	503,074.00	503,074.00	503,074.00	503,074.00
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-
Grantet donatore	101,994.01	70,641.00	-	-	-
Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-

Tabela: Trendët e financimit 2014-2015 dhe vlerësimet 2016-2018

Përvoja në shtetet tjera

Në nivel evropian, Keshilli i Evropës nëpërmjet Rekomandimit Nr. R(2000) 10 të Komitetit të Ministrave për kodet e sjelljes së zyrtarëve publikë (neni 14) dhe mekanizmave të praktikës së zhvilluar nga Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) vendosi një standard që është zhvilluar që prej vitit 2000. Në nivelin e BE-së nuk ka akt të mirefillte ose *acquis communautaire* për deklarimin e pasurisë. Megjithatë, në terma të përgjithshëm dhe duke iu referuar kriterëve të Kopenhagenit, BE-ja ka kërkuar nga vendet kandidatë dhe të tjera që të përfitojnë asistencë marrjen parasysh të standardeve dhe praktikave ndërkombëtare për luftimin e korrupsionit, përfshirë deklarimin e pasurive. Deklarimi i pasurive është bërë një standard *de facto* për BE-në kryesisht dhe me shumë karshi vendeve kandidatë.

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (e miratuar në vitin 2003 dhe e ratifikuar nga 181 pale) e zhvillon këtë standard në nenin 8.

Aktualisht, janë 161 vende që kanë vendosur një sistem të deklarimit të pasurive të zyrtareve publike.

Kroacia

Kroacia ka centralizuar luftën kundër korrupsionit nën një organizatë, Zyra për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, me një mandat të gjerë politik për të hetuar, ndjekur dhe parandaluar korrupsionin bazuar në legjislacionin e saj themelues.

Kompetencat për hetimin e korrupsionit në Kroaci ndahen nga Zyra për Mbështetjen e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe një njësi e specializuar brenda policisë, Zyrës Kombëtare të Policisë për Ndalimin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Të dy organet e zbatimit të ligjit janë të pajisur mirë për të kryer hetime efektive dhe kanë zhvilluar një rekord të mirë të hetimeve në akuzat për korrupsion të nivelit të lartë. Zyra për Mbështetjen e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gëzon një mandat të gjerë për të hetuar, ndjekur dhe parandaluar korrupsionin dhe krimin e organizuar. Ajo është gjithashtu përgjegjëse për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe shkëmbimin e informacionit në hetimet komplekse. Fokusi i saj është në rastet e korrupsionit të mesëm dhe të nivelit të lartë, me raste të korrupsionit të vogla që hetohen dhe ndiqen nga prokurorët e rregullt.

Organe të tjera anti-korrupsion përfshijnë Departamentin e Pastrimit të Parave; Zyra e Kontrollit Shtetëror; Administrata Tatimore dhe Drejtoria e Doganave në kuadër të Ministrisë së Financave; Zyra për Prokurime Publike; Komisioni për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Kryerjen e Detyrave Publike; dhe Sektorin e Pavarur Kundër Korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë.

Këshilli Kombëtar për Monitorimin e Strategjisë Kundër Korrupsionit është një komision i posaçëm parlamentar me qëllim të koordinimit të zbatimit të Strategjisë Kundër Korrupsionit dhe Planit të Veprimit. Ky Këshill është i ngarkuar me vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit dhe propozimin dhe hartimin e masave parandaluese. Departamentet e posaçme të gjykatave janë themeluar në katër gjykata të qarkut. Këto gjykata të veçanta merren vetëm me korrupsionin e mesëm dhe të nivelit të lartë dhe rastet e lidhura me krimin e organizuar.

Mali i Zi

Pas themelimit të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit në janar 2016, kuadri institucional anti-korrupsion i unifikuar dhe forcuar përpjekjet anti-korrupsion në Malin e Zi. Agjencia mori përgjegjësitë e Drejtorisë për Iniciativën Kundër Korrupsionit dhe Komisionit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Agjencia është përgjegjëse për zbatimin e masave për parandalimin e konfliktit të interesave publike dhe private, kufizimet në ushtrimin e funksioneve publike, mbledhjen dhe kontrollimin e raporteve mbi pasuritë dhe të ardhurat e zyrtarëve publikë, marrjen dhe veprimin në raportet e bilbilfryrës, mbrojtjen e informatorëve dhe Çështje të tjera të rëndësishme për parandalimin dhe shtypjen e korrupsionit, në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit. Agjencia është gjithashtu përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për financimin e subjekteve politike dhe fushatave zgjedhore dhe Ligjit për Lobim. Gjithashtu, jep mendimin për projektligjet dhe bën hulumtime në fushën e anti-korrupsionit. Agjencia është një organ i pavarur dhe autonom.

Organet kryesore hetuese anti-korrupsion janë Departamenti për Luftën Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit në Sektorin e Policisë Kriminale të Drejtorisë së Policisë dhe Administratës për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.

Shqipëria

Në Shqipëri nuk ka agjenci kryesore të centralizuar përgjegjëse për anti-korrupsionin, megjithatë është krijuar institucioni i Koordinatorit Kombëtar për Anti-Korrupsion për të koordinuar aktivitetet anti-korrupsion të Qeverisë dhe institucioneve të pavarura në nivel qendror dhe lokal. Për më tepër, është krijuar një rrjet i pikave të kontaktit në të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura, të cilat do të monitorojnë dhe udhëzojnë zyrtarët përkatës në zbatimin e Strategjisë Kundër Korrupsionit dhe do t'i raportojnë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit.

Organet kryesore parandaluese anti-korrupsion në Shqipëri janë Task Forca kundër Korrupsionit dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konflikteve të Interesave. Task Forca Anti-Korrupsion u krijua si një organ politik në nivel ministror dhe është kryesisht përgjegjës për përcaktimin e objektivave strategjike, prioritetive dhe masave në luftën kundër korrupsionit dhe gjithashtu për të siguruar përputhshmëri midis entiteteve dhe politikave anti-korrupsion brenda ministrive të ndryshme. ILDKP është themeluar si një organ i pavarur i ngarkuar për mbledhjen e deklaramit të

pasurisë dhe identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit në lidhje me zyrtarët publikë.

Lidhur me atributet e hetimit, këto aktivitete kryhen nga Prokuroria për Krime të Rënda dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Si pjesë e përpjekjeve antikorrupsion të vendit, në shtator të vitit 2014 u krijua një organ i ri i quajtur Seksioni për Hetimin e Korrupsionit dhe Pasurive në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, i cili synon të hetojë rastet e korrupsionit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe zyrtarëve të lartë. I vetmi organ që ka pushtetin për të hetuar dhe ndjekur rastet e korrupsionit në Shqipëri është Prokuroria.

Bosnja

Disa agjenci në Bosnje dhe Herzegovinë punojnë në mënyrë specifike në luftën kundër korrupsionit dhe përgjegjësitë ndahen midis ministrive, agjencive dhe zyrave të ndryshme.

Kompetencat për hetimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit ndahen nga Agjencia Shtetërore e Hetimit dhe Mbrojtjes dhe Departamenti Special për Krimin e Organizuar, Krimin Ekonomik dhe Korrupsionin në Prokurorinë e Bosnjës dhe Hercegovinës. Ministria e Sigurisë dhe në veçanti Agjencia Shtetërore e Hetimit dhe Mbrojtjes mund të konsiderohen mekanizmat më të fuqishëm në dispozicion për të koordinuar përpjekjet anti-korrupsion në Bosnje dhe Herzegovinë.

Agjencia Shtetërore e Hetimit dhe Mbrojtjes (SIPA) është një agjenci anti-korrupsion e mbështetur ndërkombëtarisht nga niveli shtetëror, i ngarkuar për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit me interes për zbatimin e ligjeve ndërkombëtare dhe kodeve penale të Bosnjës. Departamenti i Hetimeve Kriminale të SIPA-s dhe Departamenti i Inteligjencës Financiare janë përgjegjëse për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale që bien nën juridiksionin e Gjykatës së Bosnjës.

Parandalimi, edukimi dhe koordinimi i aktiviteteve anti-korrupsion, duke përfshirë analizën e tendencave të korrupsionit, zhvillimin e politikave anti-korrupsion dhe monitorimin e zbatimit të tyre janë përgjegjësitë kryesore të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit dhe Koordinimin e Luftës Kundër Korrupsionit, Është një organ i pavarur që i raporton parlamentit.

Bulgaria

Bullgaria ka një kuadër të gjerë të institucioneve të specializuara në luftën kundër korrupsionit. Si pjesë e përpjekjeve të vendit për të frenuar korrupsionin dhe për të rritur besimin e publikut në institucionet publike në përgjithësi dhe në gjyqësi në veçanti, qeveria themeloi Agjencinë Shtetërore për Sigurinë Publike. Është njësi kryesore e specializuar e cila heton dhe ndjek penalisht krimet e lidhura me korrupsionin, të kryera në vend, duke përfshirë zyrtarë të lartë publikë.

Kompetencat për hetimin dhe ndjekjen e korrupsionit ndahen nga Agjencia Shtetërore për Sigurinë Kombëtare, Drejtoria e Sigurisë së Brendshme brenda Ministrisë së Brendshme dhe Prokurorisë. Korrupsioni i nivelit të ulët është hetuar nga policia e zakonshme nën mbikëqyrjen e Ministrisë së Brendshme.

Bullgaria krijoi një gjykatë të specializuar për t'u marrë me krimet e kryera nga grupe të organizuara kriminale, përfshirë krimet e lidhura me korrupsionin. Megjithatë, vendi ende nuk ka një gjykatë të dedikuar për t'u marrë me veprat penale të korrupsionit. Qendra për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është një organ anti-korrupsion i caktuar për të mbështetur të gjitha institucionet që merren me veprime të ndjeshme ndaj korrupsionit në Bullgari. Grumbullon dhe regjistron informacion nga të gjitha fushat e ndjeshme ndaj korrupsionit, vlerëson të dhënat dhe përpunon pikat e dobëta të korrupsionit dhe krimin e organizuar duke përdorur analiza komplekse. Ajo ka një funksion analitik dhe konsultativ në zhvillimin e Sistemit të Sistemeve të Sigurta të Zgjidhjes sipas kërkesës.

Institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin dhe koordinimin e politikave anti-korrupsion është Komisioni për Parandalimin dhe Luftimin e Korrupsionit.

Serbia

Disa agjenci në Serbi posaçërisht punojnë në luftën kundër korrupsionit. Megjithatë, përgjegjësitë kryesore në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit janë të përbashkëta nga Agjencia Antikorrupsion e Serbisë, Këshilli Kundër Korrupsionit dhe Zyra e Prokurorisë për Krimin e Organizuar.

Agjencia Antikorrupsion e Serbisë është një organizëm i përkushtuar i parandalimit të korrupsionit i themeluar si një organ autonom dhe i pavarur. Agjencia koordinon strategjinë kombëtare kundër korrupsionit dhe ka një sërë funksionesh të tjera parandaluese, duke përfshirë plane integriteti në administratën publike dhe kontrollin e financimit të partive politike. Agjencia Kundër Korrupsionit i përgjigjet Asamblesë Kombëtare Serbe, të cilës i raporton

çdo vit për punën e Agjencisë, si dhe për statusin e zbatimit të Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit dhe Planeve të Veprimit.

Organi kryesor hetimor dhe prokurorial që merret me rastet e korrupsionit është Prokuroria për Krimin e Organizuar. Këshilli Kundër Korrupsionit vepron si një organ këshillimor për qeverinë. Misioni i saj është të propozojë masa që duhet të ndërmerren për të luftuar korrupsionin në mënyrë efektive, për të monitoruar zbatimin e tyre dhe për të bërë propozime për rregulloret dhe programet në këtë fushë.

Komisioni i Republikës për Mbrojtjen e të Drejtave në Procedurën e Prokurimit Publik ofron kontrole dhe balancime mbi rregullsinë e procesit të prokurimit publik. Departamenti Special për Krimin e Organizuar brenda Gjykatës së Lartë në Beograd është themeluar për t'u marrë me krimet e kryera nga grupe të organizuara kriminale, përfshirë krimet e lidhura me korrupsionin.

Gjatë hartimit të ligjeve të reja vëmendje të posaçme do t'i kushtohet neneve të mëposhtme:

- Konventa e kombeve të bashkuara kundër korrupsionit (nenet 7, 8, 10, 21 dhe 30) - united nations convention against corruption (articles 7, 8, 10, 21, 30),
- Konventa evropiane për të drejtat e njeriut (neni 8) - european convention on human rights (article 8),
- Konventa e këshillit të evropës për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale - council of europe convention for the protection of individuals with regard to automatic processing of personal data
- Konventa e të drejtës penale mbi korrupsionin - criminal law convention on corruption (ets 173)
- Konventa e të drejtës civile mbi korrupsionin - civil law convention on corruption (ets 174)
- Rezoluta (97) 24 në lidhje me njëzet parimet mbi luftimin e korrupsionit - resolution (97) 24 concerning twenty guiding principles on the fight against corruption
- Rezoluta (2000)10 e 11 maj 2000 në lidhje me kodin e etikës së zyrtarëve të lartëpublik - rec(2000)10 e 11 may 2000 on codes of conduct for public officials
- Rezoluta (2003)4 e komitetit të ministrave të shteteve anëtare në lidhje me rregullat e përbashkëta kundër korrupsionit në lidhje me financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore - rec (2003)4 of the committee of ministers to member states on common rules against corruption in the funding of political parties and electoral campaigns

- Rezoluta (2014)7 e komitetit të ministrave të shteteve anëtare për mbrojtjen e sinjalizuesve - rec (2014)7 of the committee of ministers to member states on the protection of whistle-blowers

Kapitulli 3: Synimet dhe objektivat

Synimi

Synimi i përgjithshëm i këtij koncept dokumenti është fuqizimi i rolit të Agjencisë në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Po ashtu, synohet:

- zhvillimi i qasjes “zero tolerancë” ndaj korrupsionit;
- ndërtimi i integritetit, përgjegjësisë dhe transparencës në punën e organeve të administratës publike dhe forcimin e besimit të qytetarëve në institucionet publike;
- përmirësimi i legjislacionit dhe fuqizimi i kapaciteteve institucionale për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit;
- ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut të gjerë në fushën kundër-korrupsioni;
- zhvillimi i Strategjisë dhe Planit Strategjik pesëvjeçar për nevojat e Agjencisë në fushën e Burimeve Njerëzore që kanë të bëjnë me: ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit të Agjencisë;
- avancimin e stafit në lidhje me zhvillimin e procedurës së hetimeve paraprake, trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, deklarimit të pasurisë, pranimit të dhuratave, veçanërisht pas inkriminimit të tyre në Kodin Penal.

Përmes kësaj politike synohet që të ngritet bashkëpunimi me mekanizmat institucional përgjegjës për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në Kosovë, dhe Zhvillimi i Strategjisë së Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun. Agjencia përmes ndryshimit të këtyre ligjeve kërkon të angazhohet më tepër në fushën e edukimit, bashkëpunimit, raportet me media dhe shoqërinë civile, si dhe angazhimin në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar. Si rezultat i kësaj, Agjencia kërkon që të merr kompetenca shtesë në fushat që lidhen me hetimin dhe parandalimin e korrupsionit, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë publik dhe parandalimin e korrupsionit në aktivitetet e prokurimit publik.

Kapitulli 4: Opsionet

Opsioni 1: Opsioni status quo (asnjë ndryshim)

Mos-ndryshimi i politikës/ligjit do të mundëson vazhdimin e sfidave tashmë të identifikuar në këtë koncept dokument. Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë do të vazhdojnë të mos mbulojnë të gjitha zbraztirat juridike të identifikuar deri më tani gjatë zbatimit të tyre. AKK do të vazhdojë të ketë vështirësi në realizimin e misionit të saj në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë.

Opsioni 2: Ndryshimi i politikës ekzistuese

Politika ekzistuese mund të ndryshohet me miratimin e Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë.

Ndryshimi i këtyre ligjeve i mundëson AKK-së që të merr kompetenca shtesë në fushat që lidhet me hetimin dhe parandalimin e korrupsionit, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë publik dhe parandalimin e korrupsionit në aktivitetet e prokurimit publik, si dhe kompetenca eventuale shtesë të cilat janë diskutuar nëpër tryeza dhe janë paraqitur në dokumente të ndryshme teknike.

Përmes ndryshimit të kësaj politike, ndër të tjera, do të precizohet verifikimi dhe prejardhja e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik; do të përkufizohet më mirë lista e zyrtarëve të lartë publik; do të rregullohet deklarimi i pasurisë në formën digjitale - online (e-deklarimi); do të rregullohet vlera e pasurisë së deklaruar, etj. Po ashtu, Agjencia përmes ndryshimit të politikës ekzistuese do të angazhohet edhe më tutje në fushën e edukimit, bashkëpunimit, raportet me media dhe shoqërinë civile, sidhe angazhimin në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Po ashtu, do të bëhet rregullimi i politikës ndëshkimore dhe gjetja e metodave të tjera të ndëshkimeve të zyrtarëve të lartë publik - ndalja e pagës për disa muaj, dënimi me gjobë të plotësohet me mundësinë shtesë të sanksionimit me burgim, shkarkimi nga detyra, etj.

AKK-ja do të zhvillojë më tej kapacitetin e vet parandalues, duke ruajtur kompetencat e hetimeve paraprake administrative në minimumin që kërkon ndarje të qartë dhe sqarime. Disa kapacitete hetimore janë të nevojshme për të verifikuar përmbajtjen e deklarimeve të pasurisë së zyrtarëve të lartë dhe për të mbledhur dëshmi që mbështetin analiza të rrezikut në disa sektorë të ndjeshëm ndaj korrupsionit dhe aktivitete si prokurimi publik, procesi i privatizimit, licensimi etj.

Me ndryshimin e politikës ekzistuese ligjet në fjalë do të jenë të harmonizuara me dispozitat ligjore relevante në fuqi në vend dhe me praktikat e BE-së, Konventat Evropiane dhe standardet Ndërkombëtare.

Po ashtu, Kosova do të siguronte mbrojtje të njëjtë me vendet tjera të rajonit dhe BE-së në fushat që lidhen me hetimin dhe parandalimin e korrupsionit, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë publik dhe parandalimin e korrupsionit në aktivitete e prokurimit publik, si dhe kompetencave eventuale tjera shtesë. Për më tepër, do të lehtësonte procesin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit mes Kosovës dhe BE-së dhe do të ndikonte pozitivisht në përmbushjen e kërkesave që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit dhe rendit juridik në Kosovë.

Përgjegjës për zbatimin e politikës/ ligjit do të jenë Agjencia Kundër Korrupsionit. Në këtë kontekst, nuk do të ketë nevojë për personel shtesë, por do të ketë nevojë vetëm për trajnime të cilat do të mbuloohen nga donatorët. Trajnimet janë të nevojshme për të ngritur kapacitetet e stafit profesional dhe stafit mbështetës në implementimin e kësaj politike.

Sensibilizimi i qytetarëve për përgjegjësitë dhe veprimtarinë e AKK-së bëhet përmes mjeteve të aplikuueshme informuese (ueb faqe të AKK-së, broshurave, mjeteve elektronike, mjeteve të shkruara si dhe mjeteve tjera).

Opsioni 3: Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit

Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit, si alternativë nuk përkon me qëllimin që është fuqizimi i rolit të Agjencisë. Ndryshimi i qasjes ekzistuese është shumë e vështirë të bëhet duke marrë parasysh që ligjet ekzistuese nuk kanë përcaktuar në mënyrë të qartë rregullimin dhe përcaktimin e funksioneve, detyrave dhe përgjegjësiive të AKK-së.

Prandaj, opsioni i tretë do të ishte dukshëm më i komplikuar dhe nuk do të ofronte zgjidhje.

Kapitulli 5: Përmbledhje e opsioneve

Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit.	Status quo	Ligjet e reja të veçanta	Ndryshimi i çasjes ekzistuese
Segmenti i popullsisë / sektori / rajoni i shënjestruar.	Të gjithë personat zyrtarë	Të gjithë personat zyrtarë	Të gjithë personat zyrtarë
Karakteristikat e zbatimit – kush është përgjegjës – një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët.	AKK dhe të gjitha institucionet përkatëse	AKK dhe të gjitha institucionet përkatëse	AKK dhe të gjitha institucionet përkatëse
Administrimit ose zbatimi i programit ose shërbimit	N/A	N/A	N/A
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet.	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, • Ligji nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë, • Ligji nr. 04/L-228 për <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullore nr. 01/2014 e punës e Agjencisë Kundër Korrupsionit 2. Rregullore nr 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit 3. Rregullore nr.02/2014 për 	Ligji i për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, • Ligji nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë, • Ligji nr. 04/L-228 për <ol style="list-style-type: none"> 1. Rregullore nr. 01/2014 e punës e Agjencisë Kundër Korrupsionit 2. Rregullore nr 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit 3. Rregullore nr.02/2014 për

	organizimin, funksionalizimin dhe menaxhimin e arkivit të Agjencisë Kundër Korrupsionit		organizimin, funksionalizimin dhe menaxhimin e arkivit të Agjencisë Kundër Korrupsionit
Stimulimet ose mos stimulimet ekonomike - subvencionet ose taksat.	N/A	N/A	N/A
Fushatat e edukimit dhe komunikimit.	-	Do të ketë nevojë për fushatë vetëdijësuse	-
Udhëzimet dhe kodet.	-	Pas miratimit të ligjit do të ketë nevojë për hartimin e akteve nënligjore	-
Afatet kohore - kur hyn në fuqi opsioni.	-	2018	-

Kapitulli 6: Analiza e opsioneve

Përfitimet

Opsioni i 1 (parë)

Ndryshimi i politikës ekzistuese do të mundësonte tejkalimin e sfidave tashmë të identifikuar në këtë koncept dokument. Miratimi i Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë do të mbulojë të gjitha zbrastirat juridike të identifikuar deri më tani gjatë zbatimit të tyre. AKK do të ketë më të lehtë realizimin e misionit të saj në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë.

Opsioni i 2 (dytë)

Ndryshimi i Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë mundëson AKK-së që të merr kompetenca shtesë në fushat që lidhen me hetimin dhe parandalimin e korrupsionit, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë publik dhe parandalimin e korrupsionit në aktivitetet e prokurimit publik, si dhe

kompetenca eventuale shtesë të cilat janë diskutuar nëpër tryeza dhe janë paraqitur në dokumente të ndryshme teknike.

Përmes ndryshimit të këtyre ligjeve precizohet verifikimi dhe prejardhja e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik; do të përkufizohet më mirë lista e zyrtarëve të lartë publik; do të rregullohet deklarimi i pasurisë në formën digjitale – online (e-deklarimi); do të rregullohet vlera e pasurisë së deklaruar, etj. Po ashtu, Agjencia përmes ndryshimit të politikës ekzistuese do të angazhohet edhe më tej në fushën e edukimit, bashkëpunimit, raportet me media dhe shoqërinë civile, si dhe angazhimin në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Po ashtu, do të bëhet rregullimi i politikës ndëshkimore dhe gjetja e metodave të tjera të ndëshkimeve të zyrtarëve të lartë publik – ndalja e pagës për disa muaj, dënimi me gjobë të plotësohet me mundësinë shtesë të sanksionimit me burgim, shkarkimi nga detyra, etj.

AKK-ja do të zhvillojë më tej kapacitetin e vet parandalues, duke ruajtur kompetencat e hetimeve paraprake administrative në minimumin që kërkon ndarje të qartë dhe sqarime. Disa kapacitete hetimore janë të nevojshme për të verifikuar përmbajtjen e deklarimeve të pasurisë së zyrtarëve të lartë dhe për të mbledhur dëshmi që mbështetin analiza të rrezikut në disa sektorë të ndjeshëm ndaj korrupsionit dhe aktivitete si prokurimi publik, procesi i privatizimit, licensimi etj.

Me ndryshimin e politikës ekzistuese ligjet në fjalë do të jenë të harmonizuara me dispozitat ligjore relevante në fuqi në vend dhe me praktikën e BE-së, Konventat Evropiane dhe standardet Ndërkombëtare.

Po ashtu, Kosova do të sigurojë mbrojtje të njëjtë me vendet tjera të rajonit dhe BE-së në fushat që lidhen me hetimin dhe parandalimin e korrupsionit, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë publik dhe parandalimin e korrupsionit në aktivitetet e prokurimit publik, si dhe kompetencave eventuale tjera shtesë. Për më tepër, do të lehtësojë procesin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit mes Kosovës dhe BE-së dhe do të ndikonte pozitivisht në përmbushjen e kërkesave që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit dhe rendit juridik në Kosovë.

Përgjegjës për zbatimin e politikës/ ligjit do të jenë Agjencia Kundër Korrupsionit. Në këtë kontekst, do të kërkojë nevojë për më shumë trajnime dhe personel. Trajnimet janë të nevojshme për të ngritur kapacitetet e stafit profesional dhe stafit mbështetës në implementimin e kësaj politike. Për të kryer punët në mënyrë kualitative dhe për të qenë efektiv dhe efikas duhet personel i mjaftueshëm.

Sensibilizimi i qytetarëve për përgjegjësitë dhe veprimtarinë e AKK-së bëhet përmes mjeteve të aplikueshme informuese (ueb faqe të AKK-së, broshurave, mjeteve elektronike, mjeteve të shkruara si dhe mjeteve tjera).

Opsioni i 3 (tretë)

Përfitimet e këtij opsioni janë përafërsisht të njëjta me përfitimet e Opsionit 2 por mënyra dhe procedurat e realizimit janë më të gjata dhe më të ndërlikuara. Ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit, si alternativë nuk përkon me qëllimin që është fuqizimi i rolit të Agjencisë. Ndryshimi i qasjes ekzistuese është shumë e vështirë të bëhet duke marrë parasysh që ligjet ekzistuese nuk kanë përcaktuar në mënyrë të qartë rregullimin dhe përcaktimin e funksioneve, detyrave dhe përgjegjësi të AKK-së.

Prandaj, opsioni i tretë do të ishte dukshëm më i komplikuar dhe nuk do të ofronte zgjidhje.

Pasojat negative:

Opsioni i 1 (parë)

Mos ndryshimi dhe plotësimi i ligjit do të ruante status quo-në. Me mosndryshimin e ligjit nuk do të bëhet Harmonizimi me dispozitat ligjore relevante në fuqi në vend dhe me praktikatat e BE-së, Konventat Evropiane dhe standardet Ndërkombëtare.

Mos miratimi i ligjit të ri do të thotë mos përcaktim i qartë i rolit të AKK në raport me iniciativën për Monitorimin e Planit të Integritetit të të gjitha institucioneve të cilat kanë për obligim miratimin e një plani të tillë.

Për më tepër, do të linte anash fuqizimin e rolit të Agjencisë në hetimet penale dhe administrative. Përveç kësaj, do të zvogëlonte edhe më tej nivelin e bashkëpunimit dhe mënyrën e komunikimit me institucionet vendore siç janë: Prokuroria, Policia, ATK-ja, MF, Dogana e Kosovës, Zyra e Auditorit, Bankat, etj. Prandaj, ky ligji është si kornizë ligjore themelore për nxjerrjen e akteve tjera nënligjore në lidhje me Strukturën Organizative - Rregulloren e brendshme për organizmin dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit

Masat sanksionuese/ndëshkuese do të vazhdojnë të mos jenë të qartësuara ashtu sikurse termi 'zyrtarë i lartë publik' nuk do të përfshijë të gjithë zyrtarët e lartë publik dhe do të vazhdojë të përfshijë disa që nuk do të duhej të ishin të cilësuar si zyrtarë të lartë publik.

Për më tepër, Kosova nuk do të siguronte mbrojtje të njëjtë me vendet tjera të rajonit dhe BE-së në fushën e Deklarimit, Prejardhjes dhe Kontrollit të Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimit, Prejardhjes dhe Kontrollit të Dhuratave për të gjithë Personave Zyrtarë dhe personave të tjerë dhe kjo do të pengonte procesin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit mes Kosovës dhe BE-së.

Opsioni i 2 (dytë)

Mos miratimi i këtij ligji do të thotë lënja anash e kompetencave shtesë që kërkohet nga AKK në fushat që lidhen me hetimin dhe parandalimin e korrupsionit, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë publik dhe parandalimin e korrupsionit në aktivitete e prokurimit publik.

Mos miratimi i ndryshimit të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit do të thotë lënie anash e fokusimit të Agjencisë në fushën e edukimit, bashkëpunimit, raportet me media dhe shoqërinë civile, si dhe angazhimin në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Mos miratimi i ndryshimeve dhe plotësimeve të ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe për të gjithë Personat Zyrtar Kosova do të thotë që Kosova nuk ka të harmonizuar legjislacionin e saj me praktikën e vendeve të BE-se dhe me konventat ndërkombëtare ashtu sikurse do të thotë që nuk e ka të rregulluar siç duhet mënyrat dhe format e sanksionimit adekuat dhe preciz në lidhje me verifikimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik;

Po ashtu, mosmiratimi i këtij ligji do të thotë mos-përkufizimi i listës së zyrtarëve të lartë publik dhe do të linte anash shumë zyrtarë që nuk janë të përfshirë deri më tani, dhe nuk do të largonte ata të cilët nuk kanë nevojë të deklarohen. Pastaj, procedurat burokratike nuk do të eliminoreshin ashtu sikurse nuk do të rregullohej deklarimi i pasurisë në formën digjitale - online.

Opsioni i 3 (tretë)

AKK-ja dëshiron zhvillojë më tej kapacitetin e vet parandalues, duke ruajtur kompetencat e hetimeve paraprake administrative në minimumin që kërkon ndarje të qartë dhe sqarime. Disa kapacitete hetimore janë të nevojshme për të verifikuar përmbajtjen e deklarimeve të pasurisë së zyrtarëve të lartë dhe për të mbledhur dëshmi që mbështetin analiza të rrezikut në disa sektorë të ndjeshëm

ndaj korrupsionit dhe aktivitete si prokurimi publik, procesi i privatizimit, licensimi etj. Mos miratimi i këtij ligji të ri do të thotë mos realizim i këtyre qëllimeve.

Duke ditur që pjesa më e madhe e punës së AKK-së bazohet dhe funksionon përmes monitorimit dhe sistemit të raportimit që ende nuk është shumë i zhvilluar. Pa mbledhjen dhe trajtimin sistematik të informacionit, do të ishte e pamundshme që AKK të identifikonte, kuptonte dhe vepronte ndaj rreziqeve të korrupsionit dhe të dinte nëse rregullat dhe standardet e vendosura janë të përshtatshme, të mjaftueshme dhe nëse përputhshmëria e tyre është efektive. Për këtë arsye, ndryshimi i ligjit thekson domosdoshmërinë që mbledhja e informacionit dhe prodhimi i analizave mbi trendet dhe zonat e rrezikut të jenë në qendër të misionit të AKK-së, dhe mos miratimi i tij nënkupton mos realizimin e misionit dhe visionit të AKK-së.

Ligji aktual për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe për të gjithë Personat Zyrtar parasheh institucionet e zbatimit të ligjit. Mirëpo ekzistojnë disa kompetenca më specifike të cilat duhet precizuar në lidhje me masat administrative dhe sanksionet të cilat i shqiptohen nga institucionet e zbatimit të ligjit - masa dhe sanksione të cilat nuk janë paraparë në këtë ligj. Si rezultat i kësaj, mos-miratimi i ndryshimeve dhe plotësimeve do të thotë që nuk do të kemi sanksione më adekuate dhe precize në lidhje me verifikimin dhe prejardhjen e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik.

Kosto

Për Opsionin nr. 2 është bashkangjitur Vlerësimi i Ndikimit Financiar të Koncept Dokumentit, në të cilin janë të përfshira tabelat e hollësishme.

Kapitulli 7: Konsultimi

Për rregullimin e fushës së Agjencisë kundër Korrupsionit dhe për deklarimin, prejardhjen e pasurisë konsultimet kanë filluar më herët dhe si rezultat i konsultimeve ka dalë konkluzioni se është e nevojshme që kjo fushë të rregullohet me hartimin e Ligjeve të reja, të cilat do të mbulojnë këtë fushë dhe do ta zëvendësojnë Ligjin për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë, të cilët janë ende në fuqi.

Në procesin e hartimit të këtij dokumenti përveç tjerash janë konsultuar edhe Raportet dhe analizat e dy ekspertëve nga projekti PECK II dhe nga dy ekspertë

të mbështetur nga projekti i UNDP-së SAEK II, të cilët kanë rekomanduar ndryshime në pjesën materiale, procedurale, strukturore – organizative. Drafti i këtij koncept dokumenti është analizuar në një varg punëtorish ku përveç Ministrisë së Drejtësisë e Agjencisë kundër Korrupsionit, të angazhuar kanë qenë edhe ekspertë nga dy projektet e lartëcekura.

Ministria e Drejtësisë është e përkushtuar që të krijoj hapësirë të nevojshme dhe të mjaftueshme për konsultim publik, gjithsesi, në periudha të ndryshme, varësisht prej fazës së procesit. Prandaj, MD në bashkëpunim me AKK, do të siguroj që të ketë gjithëpërfshirje të akterëve relevant gjatë gjithë procesit.

Konsultimi do të bëhet me këto institucione:

- Zyra për Komunikim Publik,
- Agjencia kundër Korrupsionit,
- Ministria e Punëve të Brendshme,
- Sekretariati Koordinues i Qeverisë – ZKM,
- Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale,
- Zyra për Planifikim Strategjik-ZKM,
- Zyra Ligjore- ZKM,
- Zyra për Qeverisje të Mirë-ZKM,
- Ministria e Financave,
- Njësia e Inteligjencës Financiare,
- Dogana e Kosovës;
- Ministria për Integrim Evropian,
- Prokuroria,
- Gjykatat.

Konsultimi në kuadër të konsultimeve me publikun dhe shoqërinë civile do të bëhet me:

- Jeta në Kosovë,
- Kallxo.com
- Lëvizja “FOL”
- Lëvizja “QOHU”
- Kosovo Democratic Institute KDI
- Insider,
- etj

Kapitulli 8: Krahasimi i opsioneve

1. Vlerësimi i pasojave për secilin opsion

Opsioni 1, *status quo* (asnjë ndryshim) sipas vlerësimit do mundësonte vazhdimin e sfidave tashmë të identifikuar në këtë koncept dokument. Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe ligji për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë do të vazhdojnë të mos mbulojnë të gjitha zbraztirat juridike të identifikuar deri më tani gjatë zbatimit të tyre. AKK do të vazhdojë të ketë vështirësi në realizimin e misionit të saj në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit në Kosovë, zbatimin e këtyre ligjeve që nuk u përshtatet rrethanave shoqërore politike si dhe administrimin jo efikas në luftimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Opsioni 2, ndryshimi i politikës ekzistuese mund të arrihet me miratimin e Ligjit të ri për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe ligjit të ri për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë.

Ndryshimi i këtyre ligjeve i mundëson AKK-së që të merr kompetenca shtesë në fushat që lidhen me hetimin dhe parandalimin e korrupsionit, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë publik dhe parandalimin e korrupsionit në aktivitetet e prokurimit publik, si dhe kompetenca eventuale shtesë të cilat janë diskutuar nëpër tryeza dhe janë paraqitur në dokumente të ndryshme teknike.

Përmes ndryshimit të kësaj politike, ndër të tjera, do të precizohet verifikimi dhe prejardhja e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik; do të përkufizohet më mirë lista e zyrtarëve të lartë publik; do të rregullohet deklarimi i pasurisë në formën digjitale - online (e-deklarimi); do të rregullohet vlera e pasurisë së deklaruar, etj. Po ashtu, Agjencia përmes ndryshimit të politikës ekzistuese do të angazhohet edhe më tutje në fushën e edukimit, bashkëpunimit, raportet me media dhe shoqërinë civile si dhe angazhimin në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar. Po ashtu, do të bëhet rregullimi i politikës ndëshkimore dhe gjetja e metodeve të tjera të ndëshkimeve të zyrtarëve të lartë publik - ndalja e pagës për disa muaj, dënimit me gjobë t'i mundësohet mundësia shtesë e sanksionimit me burgim, shkarkimi nga detyra, etj.

AKK-ja do të zhvillojë më tej kapacitetin e vet parandalues, duke ruajtur kompetencat e hetimeve paraprake administrative në minimumin që kërkon ndarje të qartë dhe sqarime. Disa kapacitete hetimore janë të nevojshme për të verifikuar përmbajtjen e deklarimeve të pasurisë së zyrtarëve të lartë dhe për të mbledhur dëshmi që mbështetin analiza të rrezikut në disa sektorë të ndjeshëm

ndaj korrupsionit dhe aktivitete si prokurimi publik, procesi i privatizimit, licensimi etj.

Përgjegjës për zbatimin e politikës/ ligjit do të jenë Agjencia Kundër Korrupsionit. Në këtë kontekst, do të ketë nevojë për më shumë trajnime dhe personel. Trajnimet janë të nevojshme për të ngritur kapacitetet e stafit profesional dhe stafit mbështetës në implementimin e kësaj politike. Për te kryer punët në mënyrë kualitative dhe për të qenë efektiv dhe efikas duhet personel i mjaftueshëm.

Sensibilizimi i qytetarëve për përgjegjësitë dhe veprimtarinë e AKK-së bëhet përmes mjeteve të aplikueshme informuese (ueb faqe të AKK-së, broshurave, mjeteve elektronike, mjeteve të shkruara si dhe mjeteve tjera).

Opsioni 3, ndryshimi i qasjes ekzistuese të zbatimit, si alternativë nuk përkon me qëllimin që është fuqizimi i rolit të Agjencisë. Ndryshimi i qasjes ekzistuese është shumë e vështirë të bëhet duke marrë parasysh që ligjet ekzistuese nuk kanë përcaktuar në mënyrë të qartë rregullimin dhe përcaktimin e funksioneve, detyrave dhe përgjegjësi të AKK-së.

Kapitulli 10: rekomandimi

Si opcion më i favorshëm për rekomandim konsiderohet opsioni 2, hartimi i Ligjit të ri për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Ligjit të ri për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik.

Ndryshimi i këtyre ligjeve i mundëson AKK-së që të merr kompetenca shtesë në fushat që lidhen me hetimin dhe parandalimin e korrupsionit, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave, parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë publik dhe parandalimin e korrupsionit në aktivitetet e prokurimit publik, si dhe kompetenca eventuale shtesë të cilat janë diskutuar nëpër tryeza dhe janë paraqitur në dokumente të ndryshme teknike.

Përmes ndryshimit të kësaj politike, ndër të tjera, do të precizohet verifikimi dhe prejardhja e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik; do të përkufizohet më mirë lista e zyrtarëve të lartë publik; do të rregullohet deklarimi i pasurisë në formën digjitale - online (e-deklarimi); do të rregullohet vlera e pasurisë së deklaruar, etj. Po ashtu, Agjencia përmes ndryshimit të politikës ekzistuese do të angazhohet edhe më tutje në fushën e edukimit, bashkëpunimit, raportet me mediadhe shoqërinë civile, si dhe angazhimin në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Kapitulli 11: Komunikimi

Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia kundër Korrupsionit do të ofrojnë informacione lidhur me procesin e hartimit të Projektligjeve, ku do të merren parasysh propozimet pas konsultimeve me ekspertë, me institucionet përkatëse, me shoqërinë civile dhe grupet tjera të interesit të cilët punojnë në fushën e kundër korrupsionit.

Format e komunikimit do të jenë të ndryshme, duke filluar nga takimet, punëtoritë, grupet punuese dhe publikimet në ueb faqen zyrtare të MD, AKK, dhe ZKM. Komunikimi do të jetë aktiv, i drejtpërdrejtë dhe konstruktiv.

Për iniciativat dhe aktivitetet e MD-së çdo herë ka pasur interesim të madh si nga ana e komunitetit të gazetarëve, të shoqërisë civile ashtu edhe nga ana e publikut, ku është demonstruar një gatishmëri e plotë për të bashkëpunuar në luftën kundër korrupsionit. Zyrtarët e MD-së dhe AKK-së kanë qenë gjithmonë të gatshëm që çdo të interesuari t'i ofrohet ndihma profesionale si edhe bashkëpunimi në rastet kur ka pasur dyshime të bazuara për raste korruptive.

Prandaj, komunikimi do të bëhet sipas procedurave që parashihet në rregulloret e punës së qeverisë, fillimisht duke proceduar me Konsultimet Paraprake, dhe më pas me konsultimet me publikun.

Në fund parashihet të mbahet një konferencë për media në të cilën do të paraqiten të gjitha ndryshimet dhe plotësimet e reja të këtyre ligjeve.